Shqip

# Planifikimi familjar



Interreg

ITALIA–SLOVENIJA

UNIONE EUROPEA
EVROPSKA UNIJA

INTEGRA

Progetto standard co-finanziato dal Fondo europeo di sviluppo regionale
Standardni projekt sofinancira Evropski sklad za regionalni razvoj

ITALIA-SLOVENIJA

INTEGRA

Progetto standard co-finanziato dal Fondo europeo di sviluppo regionale
Standardni projekt sofinancira Evropski sklad za regionalni razvoj

UNIONE EUROPEA
EVROPSKA UNIJA

Rete transfrontaliera per le donne migranti: integrazione sociale, salute sessuale e riproduttiva

Čezmejna mreža za priseljene ženske: socialna integracija, spolno in reproduktivno zdravje

Lead partner / Vodilni partner

UNIVERSITÀ DEGLI STUDI DI TRIESTE

Partner di progetto / Projektni partnerji

Partner associato / Pridruženi partner

Progetto finanziato a valere sul bando per progetti standard n. 4/2016 nell'ambito del Programma INTERREG V A Italia-Slovenia 2014-2020

Projekt je sofinanciran v okviru razpisa za standardne projekte št. 4/2016 - Programa INTERREG V A Italija-Slovenija 2014-2020

# Planifikimi familjar

Sherbimet e planifikimit familjar jane te tipit edukues, mjeksor ose social dhe kjo i jep mundesi njerezve te programojne numrin e femijeve qe deshirojne te kene dhe te percaktojne mjetet me ane te te cileve do te rrealizohet kjo gje. Planifikimi familjar na mundeson edhe zgjedhjen per te mos pasur femije, por edhe moshen kur duam ti kemi.
Ne Itali dhe ne Slloveni çdo grua mund te zgjedhe ne menyre te lire sistemin kontraceptiv domethene mund te zgjedhe kur dhe nese deshiron te kete femije.

## Tregues

**Sistemi riprodhues femeror**
**Sistemi riprodhues mashkullor**
**Fekondimi**
**Metodat kontraceptive**
- Preservativi mashkullor
- Preservativi femeror
- Spiralja
- Pilula kontraceptive estro-progjestative
- Pilula kontraceptive –minipilula
- Ceroti kontraceptiv
- Unaza kontraceptive
- Diafragma
- Sterilizimi i tubave
- Vazektomia

**Kontraceptivi emergjent**
**Nderprerja e shtatezanise ne menyre te vullnetshme**
**Kontraceptivi pas lindjes**
**Numra te vlefshem**
- Italia
- Sllovenia

# Sistemi riprodhues femerore

**Vagina:** pjese tubulare muskulare e traktit gjenital femeror qe shtrihet nga organet e jashtme ne qafen e mitres.

**Mitra:** organ muskulare qe mban dhe ushqen femijen gjate shtat ezanise. Pjesa e fundme e mitres mbaron ne vagine dhe quhet qafe.

**Endometri:** shtrese mukoze qe mbulon mitren.

**Tubat:** dy percjelles te holle ku veza bashkohet me spermen dhe fekondohen.

**Vezoret:** dy gjendra qe prodhojne vezore dhe hormone femerore (estradioli e progesteroni).



# Sistemi riprodhues mashkullor

**Penisi:** organi qe leshon spermen ne vagine gjate aktit seksual.

**Lafsha e penisit:** pjese lekuret qe mbeshtjelle koken e penisit. Ne disa kultura kjo pjese hiqet. Ne kete rast nderhyrja kirurgjikale duhet te behet nga mjeku per te shmangur infeksione ose hemoragji te renda.

**Testikujt:** gjendra qe permbajne spermatozoidet, domethene faren mashkullore.

**Uretra:** kanali permes te cilit kalon sperma dhe urina.



# Fekondimi

Gjate aktit seksual, sperma leshohet ne vagine, ngjitet ne miter dhe arrin tubat, ku takon vezen.
Bashkimi i spermes dhe vezes quhet fekondim dhe sjell shtatezanine.
Normalisht gruaja prodhon vezen ne mes te ciklit menstrual (ovulimin), prandaj periudha e duhur per te mbete shtatezene eshte nga dita e 8-te deri ne te 20-te te ciklit. Ndodhe qe grate te ovulojne ne momente te ndryshme dhe te paparashikuara.



# Metodat kontraceptive

## Preservativi mashkullor

Ben pjese te metodat barriere.
Preservativi eshte nje kellef i holle, me material lateksi, i cili ndalon hyrjen e spermes ne vagine dhe si rrjelloje shtatezanite e pa deshiruara.
**Eshte i vetmi mjet kontraceptiv qe garanton mbrojtjen nga semundjet seksualisht te transmetueshme (si psh sifilisi, gonorrea, hepatiti, SIDA)**
Funksionon vetem nqs vendoset para kryerjes se aktit.



### *Si te perdoret preservativi mashkullor?*

Hapeni kutine pa perdorur gershere ose mjete te tjera prerese ne menyre qe te mos demtoni permbajtjen.
Vendose preservativin duke e rrotulluar mbi penisin e ngritur dhe pastaj shtypni me gishtin tregues dhe ate te madh pjesen e preservativit qe sherben si depozite ne menyre qe te dalin ajri, pasi kjo mund te zvogeloje ndjeshmerine ose te krijoje te çara.
Menjehere pas derdhjes se spermes, terhiqeni penisin e ngritur nga vagina, duke e shterenguar fort bordin e preservativit me gishta per te evituar qe te hiqet dhe te dale sperma.

### *Eshte e mundur te riperdoret preservativi i njejte disa here?*

Absolutisht Jo, preservativi nuk riperdoret dhe nuk lahet.
Pasi perdoret eshte e keshillueshme te lidhet ne menyre qe te mos dale sperma dhe pastaj te tretet.

### *A eshte preservativi nje metode e sigurte?*

Nese perdoret ne menyre korrekte edhe pse eshte me pak efikas se pilula kontraceptive ose spirali per te mos mbetur shtatezene, eshte e vetmja metode qe te mbron nga semundjet seksualisht te transmetueshme.
Mbani preservativet ne vende jo shume te ngrohta dhe kontrolloni gjithmone daten e skadences.



## Preservativi femerore

Preservativi femerore eshte nje metode barriere qe duke u vendosur nga gruaja, ben te mundur depozitimin e spermes ne brendesi te vagines ne nje mbeshtjellse qe lidhet me dy unaza te levizhshme ne eksremitet.
Ne kete menyre, preservativi femerore ofron nje mbrojtje te dyfishte: mbron nga shtatezani te padeshiruara dhe ul mundesine e transmetimit te semundjeve seksuale (sifilidi, onorrea, epatiti, SIDA).

### *Eshte e veshtire te perdoret?*

JO, por duhet pak durim dhe prakticitet per ta futur.

### *Eshte e mundur te perdoren sebashku preservativi femerore dhe ai mashkullore?*

Jo ato sduhet te perdoren sebashku. Prej ferkimit te tyre preservativet mund te demtohen.

### *Eshte e mundur te perdoret preservativi femerore gjate ciklit?*

Po mund te perdoret gjate ciklit por para se te vendoset eshte e nevojshme te hiqet tamponi higjenike.



# Spirali

Spirali eshte nje mjet i vendosur ne miter (nga anglishtja IntraUterine Device) eshte plastike i bute dhe i levizshem, vendoset nga gjinekologu ne brendesi te mitres gjate ciklit menstrual.
Ndryshe nga çdo metode tjeter kontraceptive hormonale nuk ndikon tek ovulimi dhe nuk ndryshon ciklin menstrual tek gruaja; kjo metode ndikon ne modifikimin e ambientit te brendshem se mitres.
Ne treg ekzistojne dy tipe: spirali me progestogen dhe ai prej bakri.



## *Cili eshte ndryshimi mes dy spiraleve? Cili duhet zgjedhur?*

Spirali prej bakri kryen funksion kontraceptiv nepermjet veprimit anti-sperme: bakri, ne nivel te mitres, leshon jonet duke ndaluar keshtu fekondimin e vezes dhe duke penguar levizjen dhe mbijetesen e spermatozoideve; ky spiral mund te shkaktoje flukse menstruale me te bollshme.
Spirali me progestogen vepron duke leshuar sasi te vogla hormoni dhe ndryshe nga ai me baker ul fluksin menstrual.
Do jete gjinekologu qe do te keshilloje tipin me te pershtatshem per ty.

## *Shkakton dhimbje vendosja e spiralit?*

Jo, do te ndjesh vetem pak besdi. Vendosja kerkon vetem disa minuta dhe nuk ka nevoje per anestezi.

## *Sapo kam lindur, mund ta vendos spiralin?*

Po, 4-6 muaj pas lindjes mund te vendoset spirali.

## *Po pas nje abortit?*

Pas nje aborti te vullnetshem (NVSH) ose spontan ne tremujorin e pare mund te vendoset per te evituar shtatezani te reja te padesheruara; pra mund te kerkosh qe te ta vendosin direkt ne sallen e operimit ose gjate shtrimit.



## *Per sa kohe qendron ne miter?*

Mund te qendroje ne miter nga 3 deri ne 5 vite dhe me shume.
Mund te hiqet dhe perpara nqs shkakton ç'regullime ose nqs e kerkon.
Kur deshiron ta heqesh ose ta zevendesosh drejtohu tek gjinekologu.

# Pilula kontraceptive estro-progjestative

Pilula eshte e perbere nga nje bashkim hormonesh (progesteroni dhe estradioli) qe vendosin vezoret ne pushim ne menyre qe te bllokohet ovulimi. Pilula duhet te merret çdo dite ne te njejten ore. Marrja e pilules se pare behet diten e pare te ciklit menstrual.

## *Si te fillohen tabletat e tjera?*

Tableti me 24+4 pilula: kur mbaron nje tablete duhet ta marresh pilulen e pare te tabletit tjeter diten e neserme keshtu qe do merret çdo dite pa nderprerje.
Tableti me 21 pilula; pasi merr pilulen e 21-te te tabletit ben pushim per 7 dite dhe pastaj fillon tabletin e ri.
Pilula e pare e tabletit te ri do te merret gjithmone ne te njejten dite te javes (psh. gjithmone te henen nqs ke filluar te henen).
E rendesishme eshte qe pilula te merret ne menyre te rregullt çdo dite, te harrosh nje pilule rrite rrezikun e shtatezanise.

## *A duhet te nderpritet marrja e pilules nje periudhe pasi e kemi perdore per nje kohe te gjate?*

Jo. Nuk ka evidencim shkencore qe tregon qe eshte e nevojshme te behet nji periudhe kohore "pushim". E kunderta, nqs do te nderpritet mund te ndodhe nje shtatezan e padeshiruar. Pilula mund te perdoret pa asnje lloj problemi per shume vite pa patur nevoje te nderpritet periodikisht.

## *Nese e marr pilulen prej shume kohesh, do te jem gjithsesi e mbrojtur nga shtatezania ne momentin qe e nderpres?*

Jo. Mbrojtja nga shtatezania ndodh vetem nese pilula merret pa nderprerje.

## *Nese harroj te marr nje pilule?*

Nese harron te marresh nje pilule, mund ta marresh ate sapo te kujtohesh, por nese vonesa eshte me teper se 12 ore ndjek instruksionet ne kutine e pilules dhe merr parasysh mundesine e perdorimit te kontraceptivit te emergjences.



# Pilula kontraceptive progjestative-ose "minipilula"

Eshte nje kontraceptiv hormonal me baze progjestative. Quhet ndryshe edhe "minipilula", duke pasur ne perberje vetem progesteronin mund te perdoret edhe kur ushqen me qumesht gjiri ose ne gjitha ato situata kur nuk mund te perdoret estrogjeni.

## *Si funksionon?*

Ndalon aktivitetin e vezoreve dhe ovulimin. Duhet te merret nje pilule ne dite, ne te njejten ore, nuk eshte e nevojshme te nderpritet kur mbaron tableti dhe fillohet tableti tjeter.

## *Duhet te merret çdo dite ne te njejten ore?*

Po. Minipilula ka nje doze hormonale te ulet prandaj nese merret me nje vonese prej me teper se 3 ore mund te ule efektivitetin.

## *Nese harroj te marr pilulen, ç'fare duhet te bej?*

Merre pilulen sapo te kujtohesh. Vazhdo ta perdoresh si perhere, mund te marresh edhe dy pilula ne te njejten kohe ose ne te njejten dite.

Perdor nje metode tjeter kontraceptive (psh preservativin) per shtate ditet e tjera.

Nese ke patur rraporte seksuale ne 5 ditet para se ta harroje pilulen merr ne konsiderate perdorimin e nje kontraceptivi emergjence (pilula e dites se neserme).

## *Mund ta marr nese sapo kam lindur?*

Po mund ta perdoresh menjehere. Nuk eshte e nevojshme te presesh 6 muaj nga lindja e femijes tuaj.



# Ceroti kontraceptiv

Eshte nje kontraceptiv hormonal (permban estrogjen dhe progesteron) me doze te ulet qe ka veti te perthithet me ane te lekures, bllokon aktivitetin e vezoreve dhe ovulimin.

## *Si funksionon?*

Vendoset diten e pare te ciklit e zevendesohet çdo 7 dite per 3 jave, dhe javen e katert nderpritet. Ceroti duhet te ngjitet ne trup ne çdo moment, diten dhe naten, eshte e rendesishme te kontrollohet pasi kemi bere banjo ne menyre qe te mos hiqet.

## *Ku duhet ngjitur?*

Mund te aplikohet ne pjesen e siperme te krahut, ne kurrize, ne stomak, ne bark ose ne te pasmet, kudo qe eshte paster dhe thate, por jo tek gjiri.



# Unaza kontraceptive

Eshte metode kontraceptive hormonale (perman estrogjen dhe progesteron) formohet nga nje unaze e levizshme dhe trasparente prej nje materiali i cili tolerohet nga trupi, e qe gruaja mund ta vendose vete ne vagine.
Çdo dite leshon ne menyre te vazhdueshme sasi te vogla hormonesh qe bllokojne ovulimin.
Perdoret per 3 jave, pastaj javen e katert nderpritet. Vendosja e unazes behet diten e pare te ciklit.

### *Si mund te vendoset?*

Mund te zgjedhesh pozicionin me komod, per shembull ta vendosesh duke ngritur vetem njeren kembe, ne pozicion te kerrusur ose e shtrire.
Per ta vendosur ne menyre korrekte shtyp anet e kunderta te unazes dhe unazen e palosur shtyje ne vagine. Pozicioni i duhur nuk eshte i rendesishem, por duke e vendosur ne brendesi ndihmon qendrimin ne pozicion, dhe eshte me pak e mundur te perceptohet. Muskujt e vagines mundesojne qendrimin e unazes ne pozicion.

### *Po per ta hequr?*

Per ta hequr perdor gishtin tregues ose shterngoje dhe terhiqe me gishtin tregues dhe te mesem.

### *Po nese unaza rreshqet jashte?*

Nese unaza rreshqet jashte, laje me uje te rrjedhshem dhe rivendose perseri.



# Impianti nenlekure

Eshte nje kontraceptiv hormonal me perberje progjestative, ne dukje ka formen e nje shkopi plastik i holle e i levizshem, vendoset nen lekure ne pjesen e brenshme te krahut permes nje gjilpere. Procedura behet vetem ne ditet e ciklit.

### *Si vepron?*

Ndalon ovulimin dhe trash sekrecionet e qafes se mitres ne menyre qe te krijohet nje pengese per spermatozoidet.

### *Si vendoset?*

Impianti vendoset ne krah nen lekure nga gjinekologu ne ambulator, me nje aplikator njeperdorimesh (nuk eshte e nevojshme te prehet): gjithe procedura zgjat 2-3 minuta.

### *Ka dhimbje vendosja e tij?*

Jo, nese ndodh mjeku mund te te beje pak anestezi lokale.

### *Sapo kam abortuar, mund ta vendos impiantin?*

Pas nji abortit te vullnetshem ose spontan ne tre mujorin e pare mund te vendoset direkt gjate shtrimit.

### *Pas sa kohesh duhet zevendesuar?*

Pasi vendoset efikasiteti i tij zgjat deri ne 3 vite. Drejtohu te gjinekologu nese deshiron ta heqesh ose ta zevendesosh.



# Sterilizimi i tubave

Eshte e vetmja metode kontraceptive e pakthyeshme, pra e perhershme, i pershtatet çdo gruaje qe nuk deshiron te kete me femije. Quhet ndryshe edhe mbyllja e tubave.
Funksionon sepse tubat mbyllen, priten ose hiqen. Vezet e leshuara nga vezoret nuk mund te levizin neper tuba prandaj nuk ka kontakt mes tyre dhe spermes ne miter.

## *A eshte e dhimshme procedura?*

Procedura behet ne salle operimit ne laparoskopi. Meqe eshte nje operacion kirurgjik behet ne anestezi te plote.

## *Nuk do kem me cikel menstrual?*

Jo, cikli do te vazhdoje si normalisht.

## *Kur mund te behet?*

Ita=Normalisht procedura keshillohet mas nje moshe te caktuar dhe kur gruaja ka pasur femije, ngaqe procedura nuk zhbehet duhet te jesh i sigurte dhe nuk mund te kthehesh prapa.
Slo=Mund te behet nje kerkese tek mjeku gjinekolog pasi ke mbushur 35 vjeç, mjeku paraqet kerkesen te komisioni etik dhe nga momenti qe kjo kerkese pranohet duhet te pritet 6 muaj per te bere nderhyrjen kirurgjikale.





# Vasektomia

Eshte e vetmja menyre kontraceptive e perhershme per burrat qe nuk duan te kene femije, quhet ndryshe sterilizim ose kontraceptiv kirurgjik mashkullor.

## *Si funksionon procedura?*

Vasektomia behet ne ambulator jo ne anestezi te plote por me anestezi te pjeseshme.

## *A eshte e nevojshme te perdoret nje mjet tjeter kontraceptiv pasi behet vesektomia?*

Po, te pakten 3 muajt e pare. Do jete mjeku urolog, pas nje testi (spermiogramma), qe do t'ju komunikoje pergjigjen pozitive te nderhyrjes.

## *Kujt duhet ti drejtohem?*

Ita=mund te behet kerkese per proceduren mjekut te familjes i cili do tju pergatise nje rrecete per nje vizite tek mjeku urolog.
Slo=mund te behet kerkese tek mjeku i familjes pasi mbush 35 vjeç, mjeku paraqet kerkesen te komisioni etik dhe nga momenti qe kjo kerkese pranohet duhet te pritet 6 muaj per te bere nderhyrjen kirurgjikale.



# Kontraceptivi i emergjences

Duhet perdorur vetem ne rast urgjence, kur kryhen rraporte seksuale me rrezik shtatezanie, konsiderohet me rrezik çdo rraport i pa mbrojtur me metode kontraceptive.
Nuk duhet konsideruar si metode kontraceptive e zakonshme por vetem ne rast emergjence pasi nuk ka shume efikasitet.

## *Spirali me baker brenda mitres*

Vendoset brenda 48 oreve qe nga momenti kur keni kryer marredhenie seksuale te pambrojtura. Per kete lloj kontraceptivi emergjent duhet te drejtoheni te mjeku gjinekolog.

## *Pilula me baze **levonorgestrel 1,5 mg** ndryshe e quajtur pilula e "dites tjeter"*

Gjendet ne farmaci pa rrecete per gra jominorene, vajzat minorene kane nevoje per rrecete mjeksore.
Merret menjehere dhe jo pertej 72 oreve pasi keni kryer marredhenie seksuale te pambrojtura.

## *Pilula me baze **ulipristal acetato 30mg** ndryshe e quajtur pilula e "5 diteve "*

Gjendet ne farmaci pa rrecete per gra jominorene, vajzat minorene kane nevoje per rrecete mjeksore.
Merret menjehere dhe jo pertej 120 oreve pasi keni kryer marredhenie seksuale te pambrojtura.

## *Jam minorene, ku mund ta marr rreceten per pilulen e "dites tjeter"?*

Ita=Ne ditet e punes (nga e hena ne te premte, nuk perfshihen festat) vajzat minorene mund te drejtohen ne konsultorin familjare per te kerkuar kontraceptivin e emergjences, ne menyre autonome pa pranine dhe autorizimin e prinderve.
Ne ditet kur konsultoret jane te mbyllur (te shtunden e te dielen, dhe festat) mund te drejtohen tek sherbimi pediatrik i urgjences dhe Pronto soccorso pediatrik i spitalit Burlo Garofolo i Triestes ne menyre autonome pa pranine dhe autorizimin e prinderve.
Slo=Vajzat minorene nen 16 vjeçe qe duan te blejne ne farmaci kontraceptivin e emergjences kane nevoje per rrecete mjeku qe mund ta marrin ne Pronto soccorso te spitalit ose tek ambulatori mjeksore.



# Nderprerja e vullnetshme e shtatezanise

Nuk eshte nje mjet kontraceptiv dhe mund te kete pasoja per shendetin.
Ne Itali nderhyrja eshte e mundur deri ne diten e 90-te nga menstruacioni i fundit (Ligji 194 i 1978) dhe behet falas ne spitalin publik.
Ne Slloveni mund te kerkohet ndrehyrja tek mjeku gjinekolog brenda 10 javeve te shtatezanise, pertej 10 javeve gjinekologu ja dergon kerkesen komisionit etik.

### *Per te nderprere shtatezanine ç'fare duhet te bej?*

1. Test i vlefshem qe tregon shtatezanine: analize gjaku specifike.
2. Certifikata qe verteton shtatezanine dhe qe kerkon. nderprerjen e saj, duhet bere nga nje mjek: nga gjinekologu i konsultorit, mjeku i familjes ose gjinekologu i ambulatorit.
3. Nga dita kur leshohet certifikata duhet te kalojne 7 dite para se te kryhet nderhyrja (Ne Slloveni nuk pritet).

### *Ekzistojne dy metoda per te nderprere shtatezanine, metoda farmakologjike dhe ajo kirurgjikale.*

Metoda farmakologjike nuk kerkon anestezi dhe duhet bere brenda 49 diteve: eshte nje procedure qe parashikon marrjen e dy ilaqeve, Mifepristone (RU486) dhe Misoprostolo ne distance prej 48 oresh nga njeri-tjetri.

Metoda kirurgjikale behet ne sallen operatore me anestezi te plote ose te pjeseshme brenda 90 diteve nga menstruacioni i fundit.

### *Nuk dua te shkoj ne spital, si mund te abortoj?*

Te shkuarit ne spital eshte e vetmja zgjidhje e mundeshme dhe me e sigurta per shendetin. Aborti ne shtepi perveçse eshte i rrezikshem per ligjin italian dhe slloven eshte ilegal.

### *Duhet te kerkoj konsensusin nga burri /nga prinderit?*

Jo edhe pse je e martuar nuk sherben konsensusi i burrit.
Ita=Nese je minorene dhe deshiron te abortosh ne menyre te vullnetshme dhe nuk mund te flasesh me prinderit mund te drejtohesh tek konsultori familjar.
Slo=Nese je nje vajze me moshe nen 15 vjeç, gjinekologu do te organizoje nje takim mes tejet dhe sherbimit social.

### *Jam e huaj, a mund te kerkoj nje abort te vullnetshem ne Itali apo ne Slloveni?*

Ligji italian dhe ai slloven parashikon qe grate e huaja me ose pa permesso di soggiorno kane te drejte te abortojne.
Te gjitha informacionet e tjera rreth metodikes se aksesit te informacioneve dhe pagesa kundrejt vizites mjeksore mund te kerkohen ne konsultorin familjar italian ose ate slloven.

# Kontraceptivi pas lindjes

### Rregulla e 3-shit

Gruaja qe ushqen me gji plotesisht edhe naten: duhet te perdore kontraceptivin 3 muaj pas lindjes.
Gruaja qe ushqen me gji dhe me qumesht artificial: duhet te perdore kontraceptivin 3 jave pas lindjes.
Gruaja qe ka nderprere nje shtatezani pas javes se 12-te: duhet te perdore kontraceptivin 3 jave pas abortit.

Drejtohu te gjinekologu per te filluar kontraceptivin mbas lindjes, do te keshilloje metoden me efikase per ty.

# Numra te vlefshem - Italia

### Numri jeshil i shendetsise rajonale FVG

Numero Verde Gratuito
**800 991170**

Eshte nje numer informues falas i te gjithave strukturave publike ne rrethin e Triestes.
Obiektivi eshte te ofroje informacione homogjene, te qarta e te perditesuara dhe sa me te plota per te thjeshtuar hyrjen ne sherbimet shendetsore e socio-shendetsore. Mund te telefonsh nga e hena ne te premte nga ora **8:30 deri ne oren 13:00**.

### Numri jeshil italian kunder trafikimit

Numero Verde Gratuito
**800 290290**
Falas-Anonim-Aktiv 24 ore

Eshte nje sherbim telefonik falas, anonim e aktiv 24 ore mbi gjithe territorin nderkombetare, dhe informon qytetaret qe jane ne kushte shfrytezimi, te nenshtruara ndaj trafikimit, per mundesite qe i ofron legjislacioni italian per tu terhequr nga ky rrjet shfrytzimi. Numri jeshil drejtohet nga persona te afte qe flasin me viktimat e trafikimit ne gjuhe te ndryshme; italiane, angleze, spanjole, arabe, kineze, rrumene, ruse, shqip, ukrainase, etj.
Ne Trieste permes projektit rajonal "FVG kunder trafikimit" eshte prezent sherbimi kunder shfrytezimit i rrealizuar nga:
**CDCP onlus**
Androna degli Orti, 4
**Telefon:** 040 2605685
**Reperibilità anti tratta:** 389 2029070

### Telefon rosa-numri kombetare kunder dhunes dhe perndjekjes

1522 NUMERO ANTI VIOLENZA E STALKING

Eshte nje sherbim telefonik publik gratis, anonim dhe aktiv 24 ore. Telefonistet ofrojne informacione te vlefshme per viktimat e dhunes dhe perndjekjes dhe te orientojne drejt sherbimeve sociale-shendetesore te pranishem ne territorin kombetare.
Asistenca jepet ne gjuhen italiane, angleze, franceze, spanjole dhe arabe.

**Per te telefonuar nga Sllovenia beni prefiksin 0039 dhe pastaj numrin e lartpermendur.**

**IRCCS Burlo Garofolo – ospedale materno infantile**
via dell'Istria 65/1
Telefon: 0434 223522 (centralino)

**Pika e informacionit per te huaj**
via Giovanni Sai 7 (presso Distretto 4), 1° piano - stanza 141
Parco di San Giovanni
Telefon: 040 3997451

**Qendra e semundjeve seksualisht te transmetueshme**
via Gatteri 25/1
Palazzina "Infettivi" 1° piano - Polo Tecnologico
(pjesa e pasme e kompleksit spitalore)
Telefon: 040 3992882
Oraret e hapjes ndaj publikut: Ehene 8:00-17:00; e marte-e premte 8:00-13:30
Vizitat mjeksore: Per takime telefono ne numrin 040 3992882 ne oraret e hapjes.
Test:e hene-e ejte 8:00-13:00; e premte dhe para festa 8:00-10:00

**Qendra kunder dhunes -GOAP**
Via S. Silvestro 3/5
Telefon: 040 3478827
info@goap.it

## Konsultori familjare
## C'fare ben konsultori familjare?

Konsultori ofron keshilla dhe ndihme per shtatezani, pergatitje per lindjen, pas lindjen, ushqyerjen me gji, kontraceptivin, nderprerjen e vullnetshme te shtatezanise, probleme seksuale, keqtrajtimet dhe abuzimet. Gjithashtu ofron keshilla ligjore, ndihme psikologjike dhe sociale per grate, per burrat, per çiftet, per familjen dhe per adoleshentet. Sherbimi eshte falas dhe per te gjithe.

Rrethi i Triestes

**Konsultori familjar – Distretto 1**
via Lionello Stock 2 e Aurisina/Nabrežina
Telefon: 040 3997831
Pritja direkte e telefonike:
me ane te telefonit ose personalisht ne Via Stock: e hene, e marte, e ejte, e premte 9:00-16:00 ose te merkurren: 12:00 - 16:00
Hapesira e te rinjve e hapur pa marre takim deri ne moshen 23vjeç (ne Roiano): E ejte 14:30-17:00

**Konsultori familjar – Distretto 2**
via San Marco 11
Telefon: 040 3995566
Pritja direkte e telefonike:
Me telefon nga e hena ne te premte 9:00-13:00
Personalisht nga e hena ne te premte 9:00-16:00
Hapesira e te rinjve e hapur pa marre takim deri ne moshen 23vjeç (ne Roiano): e marte 14:30-17:30

**Konsultori familjar – Distretto 3**
via di Valmaura 59, Muggia e San Dorligo della Valle
Telefon: 040 3995800
Pritja telefonike:
nga e hena ne te ejte 9:30-12:30
e premte 10:00-12:00
Hapesira e te rinjve e hapur pa marre takim deri ne moshen 23vjeç (ne Valmaura) E ejte 13:30-17:00

**Konsultori familjar – Distretto 4**
via Giovanni Sai 7, Parco di San Giovanni
Telefon: 040 3997445
Pritja direkte e telefonike:
e hene, e merkurre, e premte 9:00-12:00
Hapesira e te rinjve e hapur pa marre takim deri ne moshen 23vjeç
E hene 14:00-17:00

Rrethi Gorizia

**Konsultori familjar – Gorizia**
via Vittorio Veneto 171, palazzina B
Telefon: 0481592869

**Konsultori familjar – Monfalcone**
via Galvani 1, presso l'ospedale San Polo
Telefon: 0481487611

Rrethi Udine

**Konsultori familjar – Udine**
via San Valentino 18 (3° piano)
Telefon: 0432553617
Pritja telefonike: Nga e hena ne te premte nga ora 8:30-13:30

Rrethi Pordenone

**Konsultori familjar – Pordenone**
Via de Paoli 21
Telefon: 0434237880
Pritja direkte dhe telefonike: nga e hena ne te premte ng ora 8-13 dhe te henen e te ejten nga ora 14-16:30

# Numra te vlefshem - Slloveni

**Ne territorin slloven perveç spitaleve ka dhe klinika te specializuara ku eshte e mundur ti drejtoheni gjinekologut.**

Per te telefonuar nga Italia beni prefiksin 00 386 dhe pastaj numrin e caktuar.

*Ljubliana*
**Univerzitetni klinični center ljubljana, porodnišnica Ljubljana**
Šlajmerjeva 3 ali Zaloška 11, 1000 Ljubljana
Telefon: (01) 522 50 50
www3.kclj.si

*Šempeter – Nova Gorica*
**Splošna bolnišnica "dr. Franca Derganca" Nova Gorica**
Ulica padlih borcev 13a
5290 Šempeter pri Novi Gorici
Telefon: (05) 330 1000
www.bolnisnica-go.si

*Maribor*
**Univerzitetni klinični center Maribor, Klinika za ginekologijo in perinatologijo, Oddelek za perinatologijo**
Ljubljanska 5, 2000 Maribor
Telefon: (02) 321 10 00
www.sb-mb.si

*Izola*
**Splošna bolnišnica Izola, Ginekološko porodniški oddelek**
Polje 40 a, 6310 Izola
Telefon: (05) 660 68 29
www.sb-izola.si

*Postojna*
**Bolnišnica za ginekologijo in porodništvo**
Prečna 4, 6230 Postojna
Telefon: (05) 700 07 20
www.bolnisnica-po.si

**Slovenska Karitas**
Kristanova ulica 1, 1000 Ljubljana
Telefon: (01) 300 59 60
info@karitas.si